

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar

MESAZH NGA DREJTUESIT E PROGRAMIT AASF

Jemi të lumtur të ndajmë me ju buletin tonë të parë, një produkt i Programit AASF, i cili synon të shkëmbejë informacione rreth aktiviteteve më të fundit dhe atyre të ardhshme të AASF.

Ashtu si AASF, ky buletin i drejtohet të gjitha palëve të interesit, bankave, institucioneve mikro-financiare (IMF), fermerëve, sipërmarrësve, si dhe kompanive dhe individëve që janë përfitues të sektorit bujqësor në Shqipëri, si ata që janë të angazhuar në sektorin prodhues dhe përpunues të produkteve bujqësore, tregtinë e pajisjeve bujqësore, si dhe ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit. Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) është një program i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në bashkëpunim dhe me mbështetje të Qeverisë së Shqipërisë, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i projektit është të mbështesë institucionet financiare shqiptare për të financuar një sektor jetik dhe me

potencial të gjerë të pashfrytëzuar të ekonomisë shqiptare - bujqësinë dhe agrobiznesin. AASF bazohet në dy shtylla siç janë mbështetja financiare dhe asistencë teknike.

AASF synon të arrijë qëllimin e saj përmes mbështetjes së Institucioneve Financiare Partnere (IFP) dhe agrobiznesit duke ofruar publikime dhe studime teknike, organizuar aktivitete rjetëzimi, fushata publike si dhe trajnime dhe ofrim të njohurive për rritje kapacitetesh.

Në këtë buletin të parë të AASF do të gjeni një përmbledhje të aktiviteteve tona kryesore gjatë muajve të fundit. Ndërtimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis institucioneve financiare dhe agrobiznesit, organizimin e trajnimeve për IFP-të, për të

kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat e agrobizneseve, si dhe promovimin e produkteve dhe publikimeve të AASF.

Më tej, do të njiheni me rubrikën "Kampionët e AASF", një rubrikë që ju prezanton me agrobiznese dhe fermerë që kanë përfituar nga asistencë për përmirësimin e prodhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor në Shqipëri.

Mezi presim të ndajmë me ju arritjet e ardhshme të AASF-së!

Frieder Woehrmann
Drejtor i Programit, AASF

Adela Leka
Zëvendës drejtoreshë e Programit, AASF



SHTYLLAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Mbulimi i Riskut të Parë të humbjeve ("FLRC")

- është një mekanizëm që shërben për rritjen e kreditimit i siguruar nga Qeveria e Shqipërisë, duke mbuluar 20% të humbjeve të shumës totale të nën-kredive të financuara me të ardhurat nga Linja e Kredisë së Agrobiznesit ose nga Shpërndarja e Riskut.



Linjat e kreditimit të agrobiznesit

si linjat e kredisë jo të siguruar për Institucionet Financiare Partnere në Shqipëri në financimin e subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata.

Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit

Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit, bazohet në pjesëmarrje në portofolin e pafinancuar, si një instrument i cili mbulon deri në 50% të shumës agregate të portofolit të nën-kredive të Agrobiznesit.



Asistencë teknike:

- Ndërtimi i kapaciteteve të Institucioneve Financiare Partnere
- Asistencë teknike specifike të sektorit të agrobiznesit

01 Aktivitete të rrjetezimit

AASF zhvilloi gjatë muajve maj dhe qershor 2019 disa aktivitete në rajonet Lushnjë, Fier, Berat, Shkodër, Korçë dhe Sarandë. Qëllimi i tyre ishte mbështetja dhe lehtësimi i komunikimit midis IFP-ve dhe agrobizneseve me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe nxitjen e partneritetit mes palëve.

Më shumë se 300 pjesëmarrës në të gjithë vendin u informuan nga AASF për mundësitë e financimeve bujqësore. Në këto aktivitete ishin të pranishëm ekipi drejtues i AASF, ekspertë të BERZH, zyrtarë qeveritarë dhe përfaqësues të IFP të cilët prezantuan aktivitetet e tyre dhe përfitimet e kësaj asistence teknike. Këto aktivitete u organizuan me mbështetjen e qeverisë shqiptare dhe BERZH-it.



02 Trajnime dhe seminare

Asistenca Teknike, është një prej komponentëve kryesor të programit e cila mbështet IFP-të, përmes trajnimeve dhe konsulencave të ndryshme me qëllim përmirësimin e klimës së kreditimit dhe për të kuptuar më shumë trendet në sektorin bujqësor. Përveç trajnimeve dhe konsulencave, IFP-të mund të përfitojnë nga ekspertë të specializuar të AASF në fusha të ndryshme teknike. Gjatë periudhës Prill-Korrik 2019, Programi përfundoi një seri trajnimesh, ku morën pjesë mbi 55 përfaqësues dhe punonjës të IFP-ve të cilët u prezantuan me Kartat Teknologjike. Këto produkte janë mjaft të rëndësishëm si për fermerët ashtu edhe për IFP-të, të cilat synojnë përmirësimin e vendimmarrjes dhe rrisin efikasitetin e aplikimeve për kredi bujqësore. Trajnimet u realizuan në Tiranë dhe degë lokale në Shkodër, Elbasan, Korçë, Berat, Fier dhe Vlorë. Në total, numri i punonjësve të IFP-ve të trajnuar për Kartat Teknologjike arriti 110 pjesëmarrës në muajt e fundit. Për shkak të interesit të lartë dhe vlerësimit të këtij instrumenti, në fund të vitit 2019, AASF do të botojë edicionin e dytë të Kartave Teknologjike, duke paraqitur rastet e investimeve bujqësore.



03 Aktivitete Promovuese


Në vitin e fundit, AASF ka marrë pjesë në panairë dhe aktivitete të mëdha për sektorin bujqësor në Tiranë dhe rajone të tjera të Shqipërisë. Gjatë këtyre panairëve, AASF u prezantoi fermerëve vendas mundësitë që Fondi ofron për fermerët, agrobizneset, tregtarët bujqësorë dhe agropërpunuesit. AASF i informoi ata për asistencat dhe promovoi mundësitë e financimit që ofrojnë IFP-të të AASF-së. Fokusi kryesor ishte në krijimin e një dialogu të hapur midis IFP-ve, agrobiznesit dhe fermerëve. Prania e AASF në panairë shërbeu për ndërtimin e bashkëpunimeve të reja dhe përmirësimin e rrjeteve ekzistuese dhe hapësirave të dialogut. Mes panairëve kombëtare bujqësore siç është "Shqipëria punon Tokën" në Tiranë, AASF morri pjesë edhe në panairin lokal të Voskopojës, një iniciativë e Ministrisë së Turizmit dhe Bashkisë Korçë. Përmes broshurave informuese dhe studimeve në fushën e bujqësisë, përfaqësues nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme në sektorin e agrobiznesit, morën më shumë informacion mbi mundësitë që AASF ofron për të mbështetur agrobiznesin në Shqipëri. Më tej, ata u njohën me mbështetjen e BERZH nëpërmjet asistencës teknike për agrobizneset "Këshilla për bizneset e vogla".



04 Studimet e Zinxhirit të Vlerës

Studimet e Zinxhirit të Vlerës të AASF ofrojnë një përmbledhje të 10 produkteve bujqësore më të rëndësishme dhe zinxhirit të tyre të vlerës në Shqipëri. Ato analizojnë zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale të zinxhirëve të vlerës, duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe sfidat, me fokus të veçantë në nevojat dhe potencialet për investime. Secila prej këtyre studimeve siguron informacione dhe rekomandime, të cilat mund të jenë

të dobishme për të orientuar strategjitë e institucioneve financiare në agrobiznes si edhe për përgatitjen e shërbimeve financiare. Përveç Institucioneve Financiare, përdorues të mundshëm të studimeve mund të jenë edhe institucionet qeveritare, shoqatat e biznesit, agjensitë e zhvillimit, akademitë dhe aktorë të tjerë të interesuar. Studimet janë zhvilluar nga ekspertë teknikë të AASF, bazuar në hulumtime të gjera në terren dhe intervista me institucione financiare, prodhues dhe përpunues të zinxhirëve të vlerës përkatëse.



KAMPIONET AASF

AGRITURIZËM HUQI

"Kampionët e AASF" janë agrobizneset që kanë përfituar ndjeshëm nga mbështetja teknike dhe financiare që ofron ky Program, për rritjen e prodhimit, shtimit të vlerës dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor shqiptar.

Gëzim Huqi dhe ndërmarrja e tij u asistuan nga Programi i AASF dhe "Këshilla për bizneset e vogla", një shërbim këshillimor teknik i BERZH, nga viti 2016 - 2018. Agriturizmi "Huqi" filloi veprimtarinë e tij në vitin 2007. Tani në vitin e tij të 12-të, agroturizëm "Huqi" përfshin një sipërfaqe prej 7 hektarësh. Ky kompleks ofron një gamë të gjerë shërbimesh turistike, nga akomodimi, karvanet, zgarat, shërbimin ushqimor, si dhe shitja e produkteve bujqësore të prodhuara nga vetë biznesi. Z. Gëzim Huqi është njohur me AASF dhe programet e tjera të BERZH-it gjatë konferencave dhe seminareve që këto programe organizuan në ambientet e agroturizmit.

"Duke bashkëpunuar me AASF, ne kemi arritur të zgjerojmë gamën e shërbimeve të ofruara në biznesin tonë, të rrisim nivelin profesional të stafit tonë dhe kapacitetet e akomodimit" - tha z. Huqi. Ai më tej, theksoi sesi programi i BERZH për biznesin e ndihmuan në zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore të biznesit.

"Dua të theksoj se programi i BERZH-it ka

ndihmuar në rritjen e nivelit profesional dhe kapacitetin e stafit tonë të linjës së parë, veçanërisht kamerierëve."

- deklaron z. Huqi.

Programi AASF dhe BERZH kanë mbështetur "Agrobiznesin Huqi" përmes programit të asistencës financiare dhe teknike për të zgjeruar kapacitetet pritëse dhe për të ofruar shërbim më të mirë me cilësi për klientët e tij.



PARTNERËT TANË

Raiffeissen Bank iu bashkua programit AASF duke nënshkruar marrëveshjen me BERZH, në datë, 29 Mars 2019, në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në ceremoninë nënshkruese morën pjesë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj dhe Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Z. Blendi Çuçi. Duke folur në emër të Qeverisë së Shqipërisë, të dy ministrat siguruan gatishmërinë e tyre për të mbështetur më tej misionin e Programit AASF për të përmirësuar mjedisin e agrobiznesit në Shqipëri. Mundësitë që programi AASF u sjell fermerëve dhe agrobiznesit, si dhe mbështetja nga qeveria e Shqipërisë dhe BERZH, së shpejti do të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.



Raiffeissen Bank tani është Institucioni Financiar Partner i 5-të që i bashkohet programit AASF, pas OTP Bank, ProCredit Bank, Intesa SanPaolo Bank dhe Fondit Besa që i janë bashkuar më herët.



Pro Credit Bank

"ProCredit Bank është një Institucion Financiar Partner i AASF. Institucioni ynë ka alokuar një shumë prej 16 milion eurosh e cila është përdorur për të siguruar mbështetje financiare për sektorin e agrobiznesit në Shqipëri" deklaroi Olsi Gjeta, Drejtori i Departamentit të Biznesit



Intesa San Paolo

"Strategjia e produktit financiar në bankën Intesa është përqendruar në mbështetjen e biznesit real dhe "segmentimi i tregut real" ai segment vjen nga bizneset e vogla siç janë fermerët." - thotë Z. Petrika Germenji, Drejtori për rajonin e Korçës



Otp Bank

Megjithëse OTP Bank është një bankë e re në tregun shqiptar, sektori i agrobiznesit është një nga segmentet kryesore të synuara për mbështetjen financiare që kjo bankë ofron. OTP Bank shpreson të arrijmë së bashku objektivat e vendosur për sektorin tuaj dhe në të njëjtën kohë të AASF."- thotë Z. Arben Haveri Drejtor Rajonal për Qarkun Shkodër



Raiffeisen Bank

"Banka jonë mbështet agrobiznesin dhe fermerët në çdo aktivitet të biznesit të tyre përkundër madhësisë dhe pozicionit të tij në industri. Si çdo hua tjetër edhe kjo është e strukturuar bazuar në ciklin e biznesit tuaj." - tha Znj. Eralda Katrosi, Drejtore Rajonale për Qarkun e Shkodrës



Fondi Besa

Fondi Besa është një Institucion Mikrofinanciar që i është bashkuar AASF që prej fillimit të Programit në vitin 2016. "Portofoli i produkteve" Besa Agro" siguron kredi për fermerët dhe agrobizneset deri në 25 000 euro me një afat kredie prej 48 muajsh." - thotë Znj. Diana Renja, Menaxhere e Degës Korçë



AASF siguron akses në financim për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: kredi dhe / ose ndarje të riskut të portofolit si për IMF-të ashtu edhe për bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjes, e cila u vihet në dispozicion nga Qeveria e Shqipërisë dhe BERZH. Shuma totale e këtij mekanizmi garancie është 180 milion euro. Programi menaxhohet nga konsorciumi i përbërë nga GFA Consulting Group (Gjermani) dhe CBS (Shqipëri) si zbatuese e programit të asistencës teknike nën AASF.



AASF

Rr. Andon Zako Çajupi, No.7, Tiranë, Albania

(T): +355 69 294 1513

(E): info@aasf.com.al

(W): www.aasf.com.al

Na ndiqni në:

The Albania Agribusiness Support Facility (AASF)